

# BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR

## në Komunën e Mitrovicës





## **BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR**

"Perspektiva gjinore bazë për planifikim ekonomik të qëndrueshëm"

Botues:

Mitrovica Women Association for Human Rights – MWAHR  
Boulevard "Isa Boletini" No 13, Mitrovica, Kosovo

Mitrovicë  
Gusht, 2021

Ky raport financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përmes Rrjetit të Mbikqyrësve të Buxhetit Gjinor (RrMBGj). Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm të autorit dhe botuesit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA, Sida, apo RrMBGj.



## Falenderime

Monitorimi i BPGJ në komuna e Mitrovicë nuk do të ishte i mundshëm për tu realizuar pa përkrahjen dhe mbështetjen financiare të RrMBGJ.

Falenderim i veçantë për kreun e komuns së Mitrovicës kryetarit të komunës z. Agim Bahtiri si dhe nënkryetarit z. Faruk Mujka, për përkrahje dhe lehtësimin e zbatimit të projektit si dhe të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit si dokument zyrtar.

Po ashtu jemi mirënjohëse z. Adem Fazliu, Zyrtar Kryesor i Financave në komunën e Mitrovicës për përkrahje me informacione shtesë të cilat e kanë pasuaruar raportin me të dhëna të verifikueshme dhe të vlefshme.

Një kontribut shumë të çmuar në realizimin e hulumtimit kanë dhënë, drejtorët e drejtorive si dhe zyrtarët administrativë të drejtorive të monituruara.

Falenderojmë, drejtorët dhe zyrtarët komunal të KK të Mitrovicës:

Valmira Sylejmani	Drejtorja e Administratës publike
Fitim Rama	Njësitë për të Drejtat e Njeriut
Besa Veseli	Zyra për Barazi Gjinore
Skender Aviu	Drejtorja e Arsmit
Nazan Kërveshi /Fitore Behrami	Drejtorja e Integriemeve Evropiane dhe Mirëqenje Sociale
Shukri Gashi/ Kreshnik Zejnullahu	Drejtorja për Financa dhe Zhvillim Ekonomik
Erseka Barani	Drejtorja e Shëndetësisë
Ekrem Sadiku	Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Tafil Peci	Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport

Falenderojmë gjithashtu përpiluesen e raportit Vetone Veliu si dhe Ylberina Peci, Xheneta Ciljeviq dhe Tringa Sadiku të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin e projektit dhe grumbullimin e të dhënave nga takimet e organizuara me zyrtar të komunës së Mitrovicës



## Përmbajtja

Shkurtesat .....	4
Për raportin .....	5
Metodologjia .....	7
Çfarë është Buxheti i Përgjegjshëm Gjnor? .....	7
Barazia Gjinore në pozita vendimmarrëse në komunën e Mitrovicës .....	10
Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik .....	12
Drejtoria e Administratës Publike .....	15
Drejtoria e Arsmiit .....	16
Drejtoria Integriemeve Evropiane dhe Mirëqenje Sociale .....	18
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .....	20
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural .....	21



## Shkurtesat

MWAHR	Mitrovica Women Association for Human Rights
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RrMBGj	Rrjeti Mbikqyrësve të Buxhetit Gjinor
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
KK të Mitrovicës	Kuvendi Komunal i Mitrovicës
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
Sida	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
DAP	Drejtorja e Administratës Publike
DKA	Drejtorja e Arsimit
DIEMS	Drejtorja e Integriteteve Evropiane dhe Mirëqenje Sociale
DSH/ASH	Drejtorja për Shëndetësi/Administrata e Shëndetësisë
DKRS	Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport
DBZHR	Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
UIBM	Universiteti Isa Boletini Mitrovicë
GGA	Grupi i Grave Asambleiste
Rez. 1325 të KB	Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë



## Për raportin

Monitorimi i nivelit të zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj) është bërë në kuadër të projektit "Perspektiva gjinore bazë për planifikim ekonomik të qëndrueshëm" në Komunën e Mitrovicës, i zbatuar nga Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR) dhe e përkrahur nga Rrjeti Grave të Kosovës (RrGK), si pjesë e Rrjetit të Mbikqyrësve të Buxhetit Gjinor (RrMBGj), me përkrahje të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Sipas z. Adem Fazliu Zyrtar Kryesor Financiar në komunën e Mitrovicës "buxheti gjinor është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në buxhetimin komunal. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve, në bazë të një analize gjinore në secilin vit të planifikimit buxhetor të komunës së Mitrovicës".

Komuna e Mitrovicës, BPGJ ka filluar ta zbaton para 8 vitetve, duke u bazuar në LBGJ Neni 5, 1.7. "caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte, dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave".

Shpresojmë që raporti i cili do të publikohet dhe do të shpërndalet institucioneve publike, shoqërisë civile dhe mediave, do të jetë një mjet i cili do të iu ndihmon me të dhënat e gjetyra gjatë monitorimit për angazhimet e tyre: zyrtarëve komunal të Mitrovicës që të angazhohen dhe të zbatojnë BPGJ në planifikimet dhe zbatimin e buxheteve dhe të jenë sa më transparent në shpenzimin e parasë publike, shoqëria civile në hartimin e projekteve po edhe iniciativave të ndryshme dhe mediat të bëjnë publikimin e raporti që qytetarët të jenë të informuar më mire se si shpenzohet paraja publike ku ata janë njëri nga burimet e alokimit buxhetit të komunës si tatim pagues.

## Qëllimi dhe objektivat e monitorimit

Qëllimi i këtij monitorimi është analizimi i zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në komunën e Mitrovicës, dhe përkushtimin e zyrtarëve përkatës që miratojnë vendime për shpërndarjen e drejtë dhe të përgjegjshme të buxhetit komunal për gra dhe burra. Raporti mund të ndikoj në rritjen e efikasitetit dhe në transparencën e shpenzimit të buxhetit.

Objektivat e projektit por edhe të këtij monitorimi janë:

- Identifikimi dhe analizimi i shpërndarjes së buxhetit përsa i takon ndarjes së shërbimeve të ndihmës sociale, subvencioneve, granteve dhe bursave, alokimet buxhetore për shërbimet e caktuara.
- Analizimi i numrit të grave dhe burrave që kanë përfituar nga një program apo projekt i caktuar brenda departamentit apo divizionit komunal të Mitrovicës.
- Të sigurojë që sistemet e menaxhimit të financave publike të përfshijnë proceset e buxhetimit gjinor.
- Hartimi i rekomandimeve kyçe për hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe buxheteve nga pikëpamja gjinore për sektorët e sipërpërmendur por edhe për procesin e buxhetimit në përgjithësi.



Të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave dhe vajzave nëpërmjet forcimit të pjesëmarrjes në planet e zhvillimit në Komunën e Mitrovicës.

Monitorimi për respektimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është punuar gjatë periudhës janar- qershor, 2021 në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Mitrovicës duke përfshirë Drejtorinë e Administratës ku në kaudër të saj vepron Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra për Barazi Gjinore, Drejtorinë e Arsmi, Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe Mirëqenje Sociale, Drejtorinë për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Bazuar në parimin e zbatimit efektiv të politikave dhe legjislacionit në nivelin ndërkombëtar, qendror dhe lokal të të drejtave të njeriut, përkatësisht grave, dhe krahas promovimit të këtyre të drejtave, monitorimi ka ndihmuar në evidentimin e pabarazive buxhetore gjinore si dhe mundësinë për të propozuar në përmirësimin e pabarazive të ndarjes së buxheteve përkatëse në raste të shpërndarjes së subvencioneve dhe ndihmave sociale për qytetarë në Komunën e Mitrovicës.

Buxheti është instrument i rëndësishëm për zhvillimin dhe transformimin e një vendi, çdo njësi të qeverisjes vendore dhe qendrore, pra edhe të komunës së Mitrovicës, sepse pa të ardhura, nuk ka zhvillim dhe prosperitet për qytetarë. PBGJ kontribon drejt një buxheti më transparent, më efikas, dhe më efektiv, për përmirësimin e jetës për gra dhe burra. Edhe pse buxheti gjinor ka filluar zbatimin në komunën e Mitrovicës qysh më parë, gjatë monitorimit kemi hasur në këto parregullsi:

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit të komunës së Mitrovicës është konkluduar:

- Të dhënat e gjetura gjatë monitorimit të drejtorive të monitoruara, hasim në mos respektim të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Drejtoritë e komunës së Mitrovicës nuk i kanë kushtuar rëndësi zbatimit të ligjit për barazi gjinore dhe kështu mungojnë rezultatet në reduktimin e pabarazive, në mes grave dhe burrave.
- Ka mungesë të pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse.
- Përfitues të subvencioneve në numër të madhë janë burrat, sepse gratë janë të privuara nga trashigimia familjare, falë normave shoqërore diskriminuese.
- Në përfitime të granteve favorizohen organizatat joqeveritare dhe klubet sportive të udhëhequra nga burrat.
- Ka raste ku komisionet vlerësuese vlerësojnë se gratë nuk posedojnë aftësi të mjaftueshme për të udhëhequr. Rasti i përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave.
- Sipas hulumtimit "Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje dhe Rezolutën - 1325 e KB dhe dialogu Kosovë – Serbi", që MWAHR ka organizuar përmes projektit "Gratë Paqja dhe Siguria, drejt marrëdhënjeve të mira fqinjësore në mes Kosovës dhe Serbisë" i cili është organizuar në tetor, 2020 me zyrtar komunal të 7 komunave të regjionit të Mitrovicës (Mitrovicë e jugut, Mitrovica veriore, Vushtrri, Skenderaj, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok), "hulumtimi tregon se zyrtarët kanë pak njohuri apo vetëm kanë ndëgjuar për mekanizma mbrojtës për barazi gjinore siq janë: ligji për barazi gjinore, Konventa e Stambollit, Rez. 1325 të KB si dhe ligje të tjera. Drejtoria duhet të organizojë trajnime për zyrtar komunal.



## Metodologjia

Objektivi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i politikave, programeve dhe buxheteve vendore nga perspektiva gjinore për drejtoritë komunale. Metodologjia është hartuar duke marrë parasysh objektivat dhe qëllimet e parashtruara më sipër. Metodot dhe teknikat e përdorura janë përpunimi i të dhënave, shqyrtimi i programeve dhe buxheteve perkatëse për drejtoritë të cilat ndajnë subvencione dhe të mira materiale, si dhe ndihma sociale në Komunën e Mitrovicës. Një vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimi i legjislacionit në fuqi në lidhje me buxhetet vendore, shërbimet sociale dhe barazinë gjinore. Të dhënat janë mbledhur përmes takimeve të rregullta me drejtorë të drejtorive si dhe të zyrtarëve komunal, duke përcjellur konkurset e shpallura përmes faqës zyrtare të Komunës së Mitrovicës si dhe përmes disa takimeve me përfitues të subvencioneve në Komunën e Mitrovicës.

## Çfarë është Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor?

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është strategji që përfshin pabarazitë gjinore në shoqëri. Buxhetet e qeverisë nuk kanë ndikimin e njëjtë në gra dhe burra, dhe jo të gjithë do të përfitojnë automatikisht nga ta në mënyrë të barabartë. Për shkak të situatave të ndryshme sociale dhe ekonomike, gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë nevoja, prioritete dhe interesa të ndryshme. Organizatat buxhetore, gjithmonë duhet të sigurojnë që: 1) Gratë dhe burrat të kenë qasje në përfitimet që ofrohen përmes shërbimeve dhe shpenzimeve; 2) Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë nevojat specifike të grave dhe burrave dhe të adresohen këto nevoja specifike përmes shërbimeve dhe shpenzimeve. BPGj është rrënjësor në kornizën ligjore të Kosovës, veçanërisht përmes Ligjit për Barazi Gjinore (2015), i cili thekson: "Neni 3 1.17." Buxhetimi gjinor - është zbatimi i integritit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve".

Pra të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë duhet të integrojnë BPGj-në, gjithashtu edhe Komuna e Mitrovicës është e obliguar të respektoj LBGJ dhe ta implemnetojë në buxhetet e planifikuara e cila sipas Zyrtarit Kryesor Financiar në komunën e Mitrovicës BPGJ ka filluar të imlementohet para 8 viteve.

BPGJ nuk kërkon rritjen e buxhetit të barabartë të shpenzimeve për gratë dhe burrat në një fushëtë caktuar. Kjo pasi gratë dhe burrat kanë nevoja të ndryshme në fusha të ndryshme të jetës dhe adresimin e plotësimin e tyre. BPGJ kërkon shpërndarje të buxheteve në sasi që t'iu përgjigjen në mënyrë të barabartë nevojave dhe përparësive të grave dhe burrave, dhe në këtë mënyrë mundësohet respektimi i ndarjes së buxhetit të përgjegjshëm gjinor dhe të zvogëlohet pabarazia gjinore.

## Përfitimet e përdorimit të BPGj-së

Ndarja më e barabartë e fondeve publike mund të ulë pabarazitë gjinore në mënyrë të veçantë, dhe të gjitha pabarazitë në përgjithësi brenda një shoqërie të caktuar.

Efektiviteti dhe efikasiteti i alokimeve burimore do të rritet nëse BPGj-ja zbatohet në mënyrë të suksesshme.

Institucionet në nivel lokal dhe qendror mund të përdorin BPGj-në për të komunikuar më mirë dhe për të mbështetur nevojat e departamenteve të tyre për institucionet dhe akterët tjerë, përfshirë Ministrinë e Financave.





Studime të ndryshme globale demonstrojnë se barazia gjinore në rritje dërgon në rritje dhe prosperitet ekonomik.

Për shkak të normave të gjinizuara, roleve gjinore të hamendësuara, paragjyqimeve dhe një sërë elementesh të tjerë të lidhur me aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, identitetin gjinor dhe orientimin seksual ndryshe, rrjedh si rezultat që shoqëritë nuk janë të barabarta, si ekonomikisht ashtu edhe në aspektin vendimmarës dhe politik.

Pabarazitë duhet të menjahen përmes legjisllacioneve antidiskriminues, apo të politikave publike të mbrojtjes sociale, që synojnë: qasje të barabartë në tregun e punës; paga të barabarta për punë të njëjta; balancim të detyrimeve dhe përgjegjësisve në jetën familjare, përfaqësimin e burrave dhe grave në vendimmarrje institucionale dhe politike si dhe në jetën publike e cila garantohet me Kushtetuten e Kosovës; Neni 7: "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e burrave dhe grave në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat tjera të jetës sociale".

Republika e Kosovës ka përfshirë në kushtetutë korniza ligjore, ku me anë të këtyre mekanizmave sigurojnë barazinë gjinore në zhvillimin e shoqërisë në të gjitha fushat e shoqërisë, por ende mbetet shumë punë për vetdijësimin e zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë. Bazuar në Qarkoret Buxhetore për komunat nga Ministria e financave dhe Transfere komunat obligohen të organizojnë takime me qytetarë për përcaktimin e projekteve kapitale komunale duke u bazuar në kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve.

Komuna e Mitrovicës çdo vit në muajin korrik organizon "Ndëgjime buxhetore me qytetarë për planifikimin e qarkores të buxhetit për vitin fiskal". Me këto takime ata përmbushin obligimin ligjor që iu përcakton qarkorja e lëshuar në vitin 2014 "Qarkoret Buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave kanë nxitur organizimet buxhetore në nivele qendrore dhe lokale për integrimin e të dhënave buxhetore të gjinisë në Kornizat e tyre Afatmesme dhe gjithashtu si një shtojcë për buxhetin e tyre vjetor. Në mënyrë më specifike, Qarkorja Buxhetore 01/2017 për Organizatat Buxhetore për Buxhetin e nivelit Qendror dhe Lokal deklaroi si në vijim: Sipas Ligjit Nr.05 / L-020 (2015) mbi Barazinë Gjinore, të gjitha institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e barazisë gjinore në të gjitha fushat, si një mjet të rëndësishëm për të siguruar se parimi i barazisë gjinore ndiqet në mbledhjen, ndarjen dhe alokimin e burimeve" (Neni 5.1.5.).

Këto takime mundësojnë rritjen e efektivitetit dhe transparencës të shpenzimit të parasë publike. BPGJ kërkon shpërndarje të buxheteve në sasi që t'iu përgjigjen në mënyrë të barabartë nevojave dhe përparësive të grave dhe burrave, dhe në këtë mënyrë mundësohet respektimi i ndarjes së buxhetit të përgjegjshëm gjinor dhe zvogëlohet pabarazia gjinore.

Institucionet qeveritare dhe komunale e kanë detyrim të punojnë për nxitjen e barazisë gjinore, bazuar në tërësinë e instrumenteve ndërkombëtare dhe vendore të ratifikuara, si dhe në legjisllacionin e miratuar dhe politikat kombëtare të hartuara siq është LBGJ. Prandaj duhet kushtuar rëndësi zbatimit të ligjeve dhe politikave për të arritur rezultate të dukshme në reduktimin e pabarazive, siq thekson LBGJ, Neni 1 "1. Ky ligj, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë; 2. Ky ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta."

Megjithatë, jo gjithmonë legjisllacioni dhe politikat e hartuara zbatohen në mënyrën e duhur në praktikë në nivelin qendror dhe vendor.



**“Pse është e  
rëndësishme  
PBGJ-ja”**

**“Transparencë, llogaridhënie,  
efikasitet, prosperitet  
BARAZI”**



## Barazia Gjinore në pozita vendimmarrëse në komunën e Mitrovicës

Tabela1. Pozitat vendimmarrëse në komunën e Mitrovicës

Punëtor			Kryetari	Nënkryetari	Kabineti i kryetarit	Kryekuvendari	Kuvendi			Komiteti për Politikë dhe Financa		
Gra	Burra	Total	Burrë	Burrë	Grua	Burrë	Gra	Burra	Total	Gra	Burra	Totali
132	240	372					12	23	35	5	6	11
35%	65%						34%	66%		45%	55%	

Sipas tabelës më lartë del që në komuna e Mitrovicës në pozita udhëheqëse janë vetëm 8 gra, prej tyre 4 drejtoresha të drejtorive si dhe 4 shefe të sektoreve të drejtorive.

Komuna e Mitrovicës udhëhiqet nga 8 gra dhe 26 burra, edhe pse sipas LBGJ, Neni 5, 1.4. "Sigurimin e proceseve të përzgjedhjes, punësimit dhe caktimit në punë, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve".

Mund të thuhet se në këtë mandatë 2017-2021 ka një lëvizje shumë të lehtë, krahasuar me mandatin paraprak 2013-2017 ku ishin vetëm dy drejtoresha të emëruara, në mandatin e tanishëm janë 4 gra që udhëheqin drejtoritë: Drejtoria e Administratës; Drejtoria e mirëqenjes sociale dhe Integriteteve Evropiane; Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit

Sipas paragrafit më lartë, në komunën e Mitrovicës gratë janë të diskriminuara dhe të anashkluara në pozita dhe procese vendimmarrëse. Kjo është rrjedhojë sepse gratë nuk gjejnë përkrahje në subjektet e tyre politike, ato nuk janë pjesë e strukturave udhëheqëse të subjektit politik. Të gjitha nëndegët e subjekteve politike udhëhiqen nga burrat. Vetëm dy gra janë nënkryetare të subjekteve politike, të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Pra përfshirja 50% e grave siq thekson LBGJ nuk gjenë zbatim brenda subjekteve të partive politike.

Drejtorët e drejtorive nominohen nga kryetari i komunës, por është praktikë që kryetarët nominojnë drejtorët sipas sygjërimeve dhe preferencave të subjekteve politike që udhëheqin komunën.

Tabela2. Drejtoritë e Komunës së Mitrovicës

No	Drejtoritë në Komunën Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Shef/e	
		Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
1	Drejtoria e administratës	22	39	61	Grua		1	5
2	Drejtoria e arsimit	3	5	8		Burrë	0	1
3	Drejtoria e integriteteve evropiane dhe mirëqenje sociale	4	4	8	Grua		0	1
4	Drejtoria e inspektionit	2	13	15		Burrë	0	1
5	Drejtoria për shërbime publike dhe infrastrukturë	4	6	10		Burrë	0	2
6	Drejtoria për financa dhe zhvillim ekonomik	15	11	26		Burrë	0	1
7	Drejtoria e planifikimit dhe urbanizmit	5	7	12		Burrë	0	1
8	Drejtoria për shëndetësi	3	1	4	Grua		0	1
9	Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural	5	3	8		Burrë	1	0
10	Drejtoria për kulturë, rini dhe sport	31	40	71		Burrë	-	-
11	Drejtoria e prokurimit	2	2	4		Burrë	0	1
12	Drejtoria e mbrojtjes së mjedisit	2	11	13	Grua		0	1
13	Drejtoria për gjeodezi, kadastrë dhe pronë	7	8	15		Burrë	1	1
14	Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim	1	4	5		Burrë	-	-
	<b>Totali</b>	<b>106</b>	<b>154</b>	<b>260</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>16</b>
	<b>%</b>	<b>41%</b>	<b>59%</b>		<b>29%</b>	<b>71%</b>	<b>16%</b>	<b>84%</b>

Tabela më lartë paraqet pjesëmarrjen e grave në komunën e Mitrovicës në pozita udhëheqëse në institucionet komunale.



Në vijim përmes tabelave do të paraqesim pasqyrën e të dhënave të grumbulluara gjatë hulumtimit të studimit të zbatimit të BPGJ në drejtori përkatëse gjatë periodës janar – qershor, 2021 në KK të Mitrovicës.

Drejtoritë e monitorara:

- Drejtoria e Administratës
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Integriteteve Evropiane dhe Mirëqenje Sociale
- Drejtoria për Shëndetësi
- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Jo rastësisht janë përzgjedhur drejtoritë e lartë përmendura. Këto drejtori posedojnë buxhete të caktuara për shpërndarje të të mirave materiale, ndihma sociale, ndihma për mirëqenje shëndetsore, subvencione për bujqësi, lehtësim të zhvillimit të karrierës, sport, kulturë, aktivitete qytetare të organizatave të shoqërisë civile.

Ky raport ka për qëllim të ndihmojë komuna e Mitrovicës e posaqërisht drejtoritë përkatëse në vlerësimin dhe planifikimin më të mirë të buxhetit të saj nga perspektiva gjinore.

Gjatë takimeve me drejtor dhe zyrtar të drejtorive kemi hasur në mungesë të të dhënave të ndarjes së shpenzimeve sipas gjinisë, nuk kanë pasur tregues për shpenzime të përfituesve sipas gjinisë.

Sipas qarkores buxhetore 2014/01 për "rritjen e efektivitetit dhe transparencës të shpenzimit të të parasë publike janë inkurajuar që t'i ndjanë treguesit dhe masat që kanë të bëjnë me individ sipas gjinisë"

Çdo vit në muajin korrik komuna e Mitrovicës, Drejtoria për Financa sëbashku me drejtoritë e komunës, organizojnë takime "Ndëgjime buxhetore me qytetarë për planifikimin e qarkores të buxhetit për vitin fiskal" duke i përfshirë qytetarët me rekomandimet gojarisht apo me shkrim nëpërmes fletushka që i pregadisnin, në hartimin e planit të qarkores buxhetore.

MWAHR çdo vit i përcjellë takimet e ndëgjimeve buxhetore, por pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e ulët. Vitin e kaluar në një takim kemi qenë prezente vetëm në përfaqësueset e MWAHR. Gjithashtu edhe sivjet ka ndodhur të shtyhet takimi për një ditë tjetër për shkak të mungesës së qytetarëve në takim.

Drejtoria e Financave po edhe drejtoritë tjera duhet të angazhohen më shumë dhe të gjejnë forma të informimit dhe ti bëjnë më atraktive po edhe më të besueshme këto takime me raporte dhe informata si psh. Të paraqesin linjat buxhetore të përfshira në planet paraprake të prozura nga qytetarët nga këto takime.



## Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik

Buxheti i komunës së Mitrovicës është një Plan Financiar për menaxhimin aktiviteteve ekonomike dhe financiare të planifikuara gjatë vitit fiskal 2021. Burimet e fondeve të buxhetit janë nga:

1. Nga grantet qeveritare; 19.000.947 euro ose 88,25%
2. Të hyrat vetanake; 2.525.766 euro ose 11,75%

Plani Financiar për vitin 2021 i KK të Mitrovicës

Tabela 3. Plani Financiar për menaxhimin aktiviteteve ekonomike dhe financiare të planifikuara gjatë vitit fiskal 2021

<b>Plani i ndarjeve buxhetore të Komunës së Mitrovicës / Subvencione dhe Transfere 2021</b>				
Nr <i>a</i>	Nën program <i>b</i>	Përshkrimi <i>c</i>	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE <i>d</i>	
<b>1</b>		<b>SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE</b>	<b>586,114.00</b>	
		<b>Grantet Qeveritare</b>	-	
		<b>Të Hyrat Vetanake</b>	<b>517,614.00</b>	
		<b>Financimi për Teatrot</b>	<b>68,500.00</b>	
1	16022	Zyra e Kryetarit	33,500.00	Përkrahje financiare kryesisht për përfitues individual, OJQ etj.
		Grantet Qeveritare	-	
		Të Hyrat Vetanake	33,500.00	
1.2	16922	Zyra e Kuvendit Komunal	20,000.00	Aktivitete për Grupin e grave asambleiste dhe projekte të tjera të Kuvendit Komunal.
		Grantet Qeveritare	-	
		Të Hyrat Vetanake	20,000.00	
1.3.1	16322	Administrata	84,900.00	Bursat e studentëve, Përkrahje e OJQ etj.
		Grantet Qeveritare	-	
		Të Hyrat Vetanake	84,900.00	
1.3.2	16522	Çështjet gjinore	3,500.00	Përkrahje financiare për OJQ, Aktivitete të barazisë gjinore,



		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	3,500.00	Aktivitete në lidhje me të drejtat e njeriut dhe barazisë shoqërore.
1.3.3	16562	Integrimet Evropiane	123,700.00	Pagesat ndaj Bashkësisë Islame për shpenzimet e varrimit si dhe Përkrahje financiare për përfitues individual
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	123,700.00	
1.7.2	18466	Menaxhimi i katastrofave natyrore	5,000.00	Përkrahje financiare për individë ose familje të prekura nga fatkeqësi potenciale natyrore.
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	5,000.00	
1.8	19610	Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim	13,000.00	Përkrahje financiare kryesisht për përfitues individual nga komunitetet
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	13,000.00	
1.9.1	47022	Bujqësia	95,000.00	Përkrahja financiare për bujqit, fermerët, bletarët, kopshtarët, etj.
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	95,000.00	
1.13.1	73031	Administrata e Shëndetësisë	35,000.00	Përkrahje financiare kryesisht për përfitues individual me probleme shëndetësore
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	35,000.00	
1.14	75606	Shërbimet sociale	4,100.00	Përkrahje financiare për familjet strehuese (të fëmijëve të braktisur).
		Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake	4,100.00	



1.13.1	85022	Kulturë, Rini dhe Sport	99,914.00	Përkrahje financiare për OJQ, Klube Sportive, Aktivitete rinore dhe kulturore etj.
		Grantet Qeveritare		
		Të Hyrat Vetanake	99,914.00	
1.13.2	85193	Teatri i Qytetit	68,500.00	Transfere për grupet teatrale për aktivitetet e tyre
		Grantet Qeveritare		
		Të Hyrat Vetanake		
		Financimi për Teatrot	68,500.00	

Linjat buxhetore të planifikuara në planin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Mitrovicës / Subvencione dhe Transfere për vitin 2021, kryesisht janë shpenzuar përmes drejtorive përkatëse për subvencione, të cilat më posht i gjeni në tabela.

Linja buxhetore 1.2 është dedikuar për Aktivitete për Grupin e grave asambleiste dhe projekte të tjera të Kuvendit Komunal, shumën prej 20,000.00 euro zakonisht e shfrytëzon "përmbaruesi", siq ka ndodhur vitin e kaluar. Pasiqë veq është në përfundim mandati i sivjem i kuvendit, sepse zgjedhjet reja lokale do tv organizohen ne tetor, 2021, sip o duket edhe në këtë vit do të ndodhë e njëjta gjë pasiqë GGA asnjherë gjat çështje ka çështje saj periudhe, nuk ka marrë iniciativa apo ka organizuar diq për për të ngritur çështje për qytetarët, zgjedhsitë e tyre por edhe për ndonjë çështje gjinore.

Linja buxhetore 1.3.2 Çështjet gjinore të dedikuara për Përkrahje financiare për OJQ, Aktivitete të barazisë gjinore, Aktivitete në lidhje me të drejtat e njeriut dhe barazisë shoqërore, janë shpenzuar 2,000.00 euro për shoqatën e Hendikosit.



## Drejtoria e Administratës Publike

Tabela 4. Drejtoria e administratës publike

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Shef/e	
	Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
<b>DAP</b>	22 (36%)	39 (64%)	61	Grua			

Tabela 5. Planifikimi për vitin 2021, niveli i pagave në Komunë për punëtor në Adminstarë Publike dhe shpenzimet për 6 mujorin e parë

Viti	Numri total punëtorëve	Gra	Burra	Paga dhe shtesa për gra €	Përqindja	Paga dhe shtesa për burra €	Përqindja	Shpenzime 01 - 06, 2021			
								Gra	Përqindja	Burra	Përqindja
2021	294	93	201	299,858.92	31.63 %	648,161.68	68.37%	93	31.63 %	201	68.37 %

Drejtoria e administratës për bursa ka miratuar një rregullore në vitin 2020 e cila thotë: Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.02.2020, me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02 / 06-0006765 / 20B-3 i datës 19.02.2020) dhe Rekomandimi i Komisionit Statutar (Konkluzioni Nr. 02 / 06-0006765 / 20b- 3 datë. 05.02.2020) të lëshuar.

Rregullorja Nr. 02/2020 për ndarjen e bursave për studentë e cila është zbatuar në vitin 2021.

Janë përcaktuar edhe kriteret për përfitim të bursës e të cilat janë:

- 1.Fëmijë i dëshmorit/veteran
- 2.Gjendja sociale dhe ekonomike e aplikuesit
- 3.Suksesi shkollor
- 4.Të mos jetë përfituesi i bursës së univerzitetit (jo bursa të dyfisht)

Tabela 6. Tabela e përfituesve të bursës

Konkurse	Aplikues			Përfitues			Komisioni vlerësues	
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra
29.10.2020	101	61	162	69	17	86/46	3	2
%	(62%)	(38%)		80%	20%			
	Shuma - Euro			43,470.00	10,710.00			

38,1640

Përfituese të bursës janë më shumë femra studente, edhe pse nuk kemi informata të sakta nga institucionet shkollore universitare (në UIBM ka më shumë vajza studente) numri më i madh që i ndjekin shkollimin, supozohet se më shumë vajzat e ndjekin shkollimin e lartë univerzitar.





## Drejtoria e Arsimit

Tabela 7. Drejtoria e arsimit

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Shef/e	
	Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
<b>DKA</b>	3 (37%)	5 (63%)	8		Burrë		Burrë

Në komunën e Mitrovicës ka gjithësejt 33 shkolla të mesme të ulëta, 5 shkolla të mesme dhe universiteti "Isa Boletini".

Nga 39 institucione shkollore vetëm 10 shkolla udhëhiqen nga gratë. Mungon një gadishmëri besimi se gratë kanë zotësi dhe njohuri për të dhëhequr. Këtë e dëshmon edhe përzgjedhja e drejtorëve të ri të shkollave në konkursin 26 qershorit, 2021.

Tabela 8. Udhëheqësit e shkollave në komunën e Mitrovicës me rrethinë

Arsimi i mesëm i ulët shkollor		Arsimi i mesëm shkollor		Arsimi universitar shkollor- UIBM			
39 Sh.m. e ulët		5 sh.mesme					
Drejtor/drejtoresha		Drejtor/drejtoresha		Rektor/e		Dekan/e	
Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra
8 (21%)	21 (79%)	2 (40%)	3 (60%)	0 (0%)	1 (100%)	0 (0%)	6 (100%)
Zv. Drejtora/eshë		Zv. drejtora		Prorektor/e		Prodekan/e	
Gra	Burra	Gra	Burra	Grua	Burrë	Gra	Burra
1 (25%)	3 (75%)	2 (67%)	1 (33%)	2 (67%)	1 (33%)	2 (20%)	8 (80%)

Tabela 9. Planifikimi për vitin 2021, niveli i pagave në Komunë për punëtor në arsim dhe shpenzimet për 6 mujorin e parë

Viti	Numri total punëtorëve	Grua	Burra	Paga dhe shtesa për gra €	Përqindja	Paga dhe shtesa për burra €	Përqindja	Shpenzime 01 – 06, 2021			
								Gra	Përqindja	Burra	Përqindja
2021	1,261	784	478	2,371,170.58	61.04 %	1,442,838.42	38.96 %	784	62.17 %	478	37.83 %

Gjatë kohës së monitorimit Drejtoria e Arsimit ka shpallur dy konkurse për vende pune për drejtor shkolle dhe për mësimdhënës dhe educator/e:

Tabela 10. Përfituesit e bursave shkollore

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Konkurse	Aplikues			Përfitues			Komisioni vlerësues	
		Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra
<b>DKA</b>	26.04.2021- Konkursi për përzgjedhjen e drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore	6 (30%)	14 (70%)	20	0 (0%)	5 (100%)	5	2	1



Sipas komisionit vlerësues asnjë grua kandidate nuk i ka plotësuar kushtet për të udhëhequr një institucion edukativo – arsimor.

Tabela tregon vullnetin e kësaj drejtorie që të respekton LBGJ por edhe mekanizmat tjerë, që gratë të përfshihen në procese vendimmarrëse, pra në vende udhëheqëse në institucione shkollore

Me 14.05.2021 Drejtorja e Arsimit shpallë konkurs – për kandidate për edukator/e dhe mësimdhënës/e, pas përzgjedhjes së kandidatëve dhe publikimit të emrave, DKA del me njoftim

Njoftimit të DKA Nr. i prot.: 7-7-111)O § — 0 OJ&OU /2021 Datë: 16. 07. 2021

Në bazë të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit për Sektorin Publik, për zbatimin e Vendimit Nr, 01-111/01-0057400/21, data: 14.07.2021, të Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për shërbimin publik, Drejtorja Komunale e Arsimit, bën këtë:

Anulohen konkurset e Drejtorisë Komunale të Arsimit

1. Konkursi Nr. Nr. 07-111/01-0020517/21; 2. Konkursi Nr. Nr. 07-111/01-0020718/21; 3. Konkursi Nr. 07-111/01-0020511/021.

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të inicojnë kontest pune, në gjykatën kompetente, 15 ditë nga dita e njoftimit me këtë vendim.

Kemi kërkuar që të na ipet vendimi për anulim të konkursit, mirëpo ka munguar vullneti i bashkëpunimit si nga DA, Zyra Ligjore por edhe nga kryetari i komisionit i cili në takim na tha " konkursi është anuluar për shkak të parregullsive teknike po edhe në vlerësimin e kandidatëve" . Edhe pse Ligji Nr, 03/L-215 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE lejon qasjen në dokumente, por gjithsesi do të dërgojmë kërkesën për qasje në dokument.



## Drejtoria e Integrimi Evropiane dhe Mirëqenje Sociale

Tabela 11 Drejtoria e Integrimi Evropiane dhe Mirëqenje Sociale

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Shef/e	
	Grua	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
<b>DIEMS</b>	4 (50%)	4 (50%)	8	Grua			

Drejtoria për Integrimi Evropiane dhe mirëqenje sociale, përkrahë financiarisht familje me probleme emergjente ekonomike, shëndetësore, strehim, familjeve të invalidve të luftës etj.

Tabela 12. Përfituesit e mjeteve financiare

Ndihma sociale	Aplikues			Përfitues			Komisioni vlerësues	
	Grua	Burra	Totali	Grua	Burra	Totali	Grua	Burra
Janar - mars 63% 31,003.63 € të buxhetit të dhënë kanë marrë gratë (ndihme shëndetësore, psikologjike, fizike) grate e dhunuara, dhuna në familje, subvencion për: pagesa qirasë për familje; ndihma emergjente dhe lehona	?	?	328	?	?	119	?	?

Ka mungesë të të dhënave se sa grua dhe sa burra janë përfitues sepse DIEMS përkrahë kryesisht familje që nënkupton se përfitues janë bashkëshortët me fëmijë si tërsi familjare.

Mungesa e të dhënëve në burra dhe grua, sipas zyrtarëve të DSH qëndron, se ata mendojnë mjafton me e përmbushë detyrën e tyre me ndarje e financave emergjente për probleme shëndetësore duke i ndihmuar qytetarët për nevojat e tyre. Mund të konkludojmë se pak ka rëndësi për ta shpërndarja e buxhetit dhe kush janë përfituesit.

Duke u bazuar në raportin e DIEMS botuar në faqën zyrtare të Komunës së Mitrovicës "Drejtoria për Integrimi Evropiane dhe Mirëqenje Sociale gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2021

- ka ndihmuar me mjete financiare emergjente 19 raste/familje në shumë prej 6450 euro
- ka ndihmuar me mjete financiare për pagesën e qirasë 38 raste/familje në shumë prej 15.353.63 euro
- fëmijët e lindur në vitin 2020, do të përfitojnë 83 familje me nga 100 euro në shumë totale prej 8300 euro.

Për transparence ndaj opinionit drejtoria duhet të përfshij si tregues numrin e grave dhe burrave përfitues të shërbimeve sociale të ndryshme.



## Drejtoria e Shëndetësisë

Tabela 13. Drejtoria e shëndetësisë

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Kryetar/e	
	Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
Drejtoria për Shëndetësi/ Administrata e Shëndetësisë DSH/ASH	3	1	4	Grua			
Emergjenca	1	4	5				
Kryesia	11	13	24				Burrë

Tabela 14. Planifikimi për vitin 2021, niveli i pagave në Komunë për punëtor në shëndetësi dhe shpenzimet për 6 mujorin e parë

Viti	Numri total punëtorëve	Grua	Burra	Paga dhe shtesa për grua €	Përqindja	Paga dhe shtesa për burra €	Përqindja	Shpenzime 01 – 06, 2021			
								Grua	Përqindja	Burra	Përqindja
2021	251	161	90	690,347.25	60.83 %	444,448.07	39.17 %	161	64.15 %	90	35.85 %

Gjatë kohës së monitorimit DSH ka ndarë mjete financiare për probleme shëndetësore, por iu mungojnë analiza të kjarta të përfituesve të mjeteve financiare në bazë gjinore.

Tabela 15. Prfituesit e mjeteve financiare

Përkrahja me mjete financiare për trajtim të problemeve shëndetësore	Shuma	Aplikues			Përfitues			Shuma - Euro				Komisioni vlerësues	
		Grua	Burra	Totali	Grua	Burra	Totali	Grua	%	Burra	%	Grua	Burra
35,000.00 Euro		408	227	635	183	152	335	20,000.00	80%	5,000.00	20%	2	1



## Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Tabela 16. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria në Komonën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/eshë		Shf/e	
	Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
DBZHR ↓ DKRS	25 (50%)	25 (50%)	50		Burrë		

Tabela 17. Planifikimi për vitin 2021, niveli i pagave në Komunë për punëtor në shëndetësi dhe shpenzimet për 6 mujorin e parë

Viti	Numri total punëtorëve	Gra	Burra	Paga dhe shtesa për gra €	Përqindja	Paga dhe shtesa për burra €	Përqindja	Shpenzime 01 – 06, 2021			
								Gra	Përqindja	Burra	Përqindja
2021	50	25	25	63,707.95	50.45 %	62,571.42	49.55 %	25	50 %	25	50%

Gjatë periudhës janar – qershor DRKS ka hapur një konkurs me datë 19.03.2021 për tri sektore: rini, sport dhe kulturë.

Shuma prej 37,50.00 -euro është ndarë dhe përfitues janë, 11 gra dhe 35 burra.

6,800.00euro janë ndarë për gra dhe 30,700.00 euro per burra.

Komisioni vlerësues ka qenë i përbër nga tre burra dhe një grua, nuk është respektuar barazia gjinore.

Gratë janë përkrahur vetëm 5% deri në 25% e shumës së ndarë, kurse burrat prej 50% deri 95% e shumës së ndarë.

DKRS nuk e ka respektuar BPGJ në ndarje të granteve duke i diskriminuar gratë me një shumë të ndarë, shumë të vogël.

Tabela 17. Përfituesit e granteve

Konkurse	Aplikues OJQ udhëhequr nga gratë			Përfitues				Komisioni vlerësues	
	Gra	Burra	Totali	Gra	Shuma - euro	Burra	Shuma - euro	Gra	Burra
19.03.2021 -Mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve lidhur me komponentën e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjëve (7.000,00 euro)	3	8	11	8	2300.00	8	6650.00	4	1
%	27%	73%		50%	(26%)	50%	(74%)		
19.03.2021 – Mbështetje financiare për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve klubeve dhe shoqatave sportive lidhur me realizimin e aktiviteteve të rregullta sportive (20.000,00 euro) - Sektor i Sportit	1	21	22	1	3000.00	21	19000.00	4	1
%	5%	95%		5%	(14%)	95%	(86%)		
19.03.2021- Ftesë organizatave program I te cilave është i fokusuar në fushën e kulturës ( festivale, botime, revistash, koloni arti, manifestime tradicionale etj (10.000,00euro)	2	6	8	2	1500.00 (23%)	6	5.050.00 (77%)	4	1
%	25%	75%		25%		75%			



## Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Tabela 19. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Drejtoria në Komunën e Mitrovicës	Numri i punëtorëve			Drejtor/esh		Shef/e	
	Gra	Burra	Totali	Grua	Burrë	Grua	Burrë
<b>DBZHR</b>	5 (62%)	3 (38%)	8		Burrë		Burrë

Gjatë periudhës së monitorimit të DBZHR kanë qenë të hapura tri thirrje dhe prej tyre përfitues me subvencione janë 22 gra dhe 118 burra

Në regjionin e Mitrovicës vetëm 15% të bizneseve udhëhiqen nga gratë, sepse pronar të tokava bujqësore kryesisht janë burrat dhe kjo vetvetiu mundëson diskriminim në ndarjen e subvencioneve për shkak të kushteve të përcaktuara nga DBZHR. Për me qenë përfitues/e e subvencioneve duhet të posedosh prone/tokë në emrin personal apo të kesh biznes të regjistruar në emrin personal.

Edhe pse gratë në thirrje publike për subvencione gëzojnë diskriminim afirmativë duke u shpërblyer me 10 pikë në start të vlerësimit, në thirrjen e 24.03.2021 asnjë grua nuk ka aplikuar.

Tabela 19. Përfituesit e subvencioneve bujqësore

Mbështetje bujqësore	Aplikues			Përfitues			Komisioni vlerësues	
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra
12.02.2021- Mbështetje me subvencione me Serra nga polietileni me sip 50m2 në sektorin e perimtarisë	12	89	101	10	50	60	2	1
	12%	88%		17%	83%			
24.03.2021 - Mbështetje fermerë me subvencione në sektorin e pemetarisë në ngritjen e infrastrukturës në pemishtet ekzistuese (arra dhe lajthi) në sipërfaqe prej 0.50 h me sistem të ujitjes.	0	12	12	0	12	12	2	1
%	0%	100%		0%	12%			
Në bashkpunim me organizatën Qatar Charity kanë implementuar projektin për mbështetjen e fermerëve	?	?	215	12	34	46	2	1
%				26%	74%			



## Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme janë nxjerrë nga gjetjet dhe analizat e hulumtimit të paraqitura, në kapitujt e mëparshëm.

Rekomandimet për komunën e Mitrovicës: kryetarin e komunës, drejtoritë komunale të Mitrovicës, zyrën për barazi gjinore.

- Institucionet komunale të Mitrovicës në bazë të mekanizmave ndërkombëtar dhe vendor për barazi gjinore e kanë detyrim të respektojnë barazinë gjinore me theks LBGJ, në të gjitha fushat shoqërore, duke implementuar BPGJ në të gjitha fazat e buxhetimit, për një ndarje të buxhetit për gratë dhe burrat dhe ulur pabarazitë gjinore në institucionet komunale dhe në shoqëri.
- Në qeverinë e re të vjeshtës 2021, të emërohet në postin e nënkryetares apo të kryekuvendares një grua dhe të emërohen sëpaku 6 gra në postin e drejtoreve të drejtorive komunale dhe të rritet numri I grave në pozita vendimmarrëse.
- Gjatë organizimit të takimeve të ndëgjimeve publike komunale për hartimin e Qarkoreve Buxhetore për vitin fiskal, zyrtarët të paraqesin linjat buxhetore të përfshira në planet paraprake të propozuara nga qytetarët nga këto takime, dhe në këtë mënyrë të fitojnë besueshmëri tek qytetarët se propozimet e tyre janë marrë në konsideratë. Në këtë mënyrë mund të rritet numri i pjesëmarrësëve në takime.
- Zyrtarët të cilët janë të angazhuar në organizime takimeve për ndëgjime publike komunale për hartimin e Qarkoreve Buxhetore duhet të punojnë sëbashku më shumë me shoqërinë civile e sidomos me organizata të grave dhe me media RTV Mitrovicën si dhe portalet vendore të Mitrovicës për të promovuar takimet e ndëgjimeve buxhetore të komunës së Mitrovicës me qyetrë të ndryshëm.
- Të bëjnë përpjekje afirmative për të fuqizuar të drejta të barabarta pronësore për gratë, në mënyrë gratë të jenë përfituese të barabarta me burra për subvencione bujqësore.
- Drejtoria e Arsimit në konkurset e rradhës të emërojë më shumë gra drejtore në shkolla pra të rrit përqindjen e grave drejtoresha prej 21% në 40%
- Drejtoria për Rini , Kulturë dhe Sport,që shpenzimet për klubet sportive të grave dhe vajzave të rriten nga 26% në 50%, gjithashtu edhe për OJQ-ët e grave dhe vajzave të rritet nga 16% në 50%.
- Komuna të alokoj resurse për trajnim bazik të zyrtarëve komunal (sa më shumë zyrtar të përfshihen në trajnime) në temat e barazisë gjinore me fokus në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, Rez.1325 të KB për gra, paqe dhe siguri, Konventën e Stambollit dhe mekanizma tjerë.
- Për rritje dhe prosperitet ekonomik si dhe alokim të buxhetit, komuna e Mitrovicës duhet të bëjë ndarjen e fondeve publike në bazë të nevojave dhe prioriteteve të grave, vajzave, burrave dhe djemve, në kë të mënyrë mund të ulë pabarazitë gjinore në mënyrë të veçantë, dhe të gjitha pabarazitë në përgjithësi, brenda një shoqërie të caktuar.



Mitrovica Women Association for Human Rights - MWAHR  
Bulevardi Isa Dohentini 140000 Mitrovica, Kosovo  
E-mail: [mwahta@gmail.com](mailto:mwahta@gmail.com)  
[www.mwahra.org](http://www.mwahra.org)  
mob: +383 (0) 44 465 751 | +383 (0) 49 150 565